



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 502/4 Prot.

Tiranë, më 15.10.2018

V E N D I M

Nr.83, datë 15.10.2018

“Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në procedurën e transferimit të përshëm në kuadër të ristrukturimit, ndaj nëpunësit ***”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunësit *****,

VËREJ SE

Nëpërmjet kërkesës së regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nr. 502 prot., datë 07.06.2018, kërkuesi ***** ka ngritur pretendimin se, procedura e transferimit të përshëm në kuadër të ristrukturimit të institucionit të Autoritetit të Aviacionit Civil, nuk është zhvilluar në përputhje me përcaktimet e nenet 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përshëm të nëpunësve civilë”.

Nga verifikimi administrativ i kryer nga Komisioneri, rezulton se, punonjësi ***** me aktin nr. 1606/20 prot., datë 30.10.2014, të Departamentit të Administratës Publike, është deklaruar “Nëpunës civil në periudhë prove”, në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Çertififikimit të Personelit të Sigurisë”, në Drejtorinë e

Mbikëqyrjes së Sigurisë në Aviacion, në Autoritetin e Aviacionit Civil, për arsye se në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, ai kishte më pak se një vit i punësuar në atë pozicion.

Rezulton se, me vendimin nr. 79, datë 21.12.2017, të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil, aprovuar me shkresën nr. 3869/5 prot., datë 16.02.2017, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, është miratuar struktura e re organizative dhe funksionale e Autoritetit të Aviacionit Civil. Në zbatim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe në përputhje me kërkesat e Kreut II, germa “b”, të udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”*, njësia përgjegjëse ka ngritur Komisionin e Ristrukturimit.

Komisioni i Ristrukturimit, pas analizës së dokumentacionit dhe të dhënave të nevojshme, në zbatim të Kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, ka përgatitur propozimin me shkrim për transferimin e nëpunësve civilë, pozicionet e punë të cilëve janë prekur nga ristrukturimi. Në përfundim të analizës së rastit objekt shqyrtimi, ky komision ka konstatuar se, *“Sektori i Certifikimit të Personelit të Sigurisë”*, në të cilin nëpunësi ***** ushtronte detyrën në pozicionin *“Inspektor”*, ka pësuar ndryshim vetëm në lidhje me emërtesën dhe tashmë është emërtuar *“Sektori i Certifikimit të Mbikëqyrjes së Personelit të Sigurisë”*.

Në këto kushte, Komisioni i Ristrukturimit, me aktin nr. 719 prot., datë 30.03.2018, ka propozuar transferimin e punonjësit ***** nga pozicioni i mëparshëm, në pozicionin e riemërtuar *“Inspektor në Sektorin e Certifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit të Sigurisë, në Drejtorinë e Sigurisë në Aviacion”*, në Autoritetin e Aviacionit Civil.

Në zbatim të pikës 20, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, Departamenti i Administratës Publike, me aktin nr. 2397/36 prot., datë 10.04.2018, *“Transferim për shkak të ristrukturimit”*, ka vendosur transferimin e përhershëm të këtij nëpunësi në pozicionin e sipërcituar. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezulton se ky punonjës ka marrë dijeni për këtë akt në datën 11.04.2018, duke shprehur miratimin e tij në lidhje me këtë transferim.

Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se, me shkresën nr. 902 prot., datë 08.05.2018, të Drejtorit Ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil, *“Kërkesë për lëvizje paralele”*, është kërkuar ndaj Komisionit të Ristrukturimit rishikimi i propozimit nr. 719 prot., datë 30.03.2018, për transferimin e nëpunësve civilë ***** dhe ***** , për interes të institucionit.

Në vijim të këtij veprimi administrativ, rezulton se, Komisioni i Ristrukturimit, në bazë të urdhrimit të mësipërme të titullarit të institucionit në fjalë, është rimbledhur dhe në përfundim të procesit të rishqyrtimit, bazuar në nenin 112, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me aktin nr. 958 prot., datë 17.05.2018, midis të tjerash ka propozuar anulimin e akteve të mëparshme të transferimit për nëpunësit ***** dhe ***** ka bërë propozimin për këmbimin reciprok të pozicioneve të punës, si më poshtë:

- Transferimin e nëpunësit ***** , nga pozicioni aktual, “*Inspektor*”, në Sektorin e Çertifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit të Sigurisë, në Drejtorinë e Sigurisë në Aviacion, në Autoritetin e Aviacionit Civil – në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e të Drejtave të Pasagjerit, në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Operatorëve Ajrore dhe Organizatave të Mirëmbajtjes, në Autoritetin e Aviacionit Civil;
- Transferimin e nëpunëses ***** , nga pozicioni aktual, “*Specialist*”, në Sektorin e të Drejtave të Pasagjerit, në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Operatorëve Ajrore dhe Organizatave të Mirëmbajtjes, në Autoritetin e Aviacionit Civil – në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Çertifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit të Sigurisë, në Drejtorinë e Sigurisë në Aviacion, në Autoritetin e Aviacionit Civil.

Departamenti i Administratës Publike, bazuar në vendimmarrjen e Komisionit të Ristrukturimit, me aktin nr. 3297/44 prot., datë 25.05.2018, ka miratuar propozimin e Komisionit të Ristrukturimit duke vendosur anulimin e aktit nr. 2397/36 prot., datë 10.04.2018, “*Transferim për shkak të ristrukturimit*” dhe transferimin e nëpunësit ***** , në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e të Drejtave të Pasagjerit, në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Operatorëve Ajrore dhe Organizatave të Mirëmbajtjes, në Autoritetin e Aviacionit Civil.

Duke mos qenë dakord me vendimin e transferimit të përhershëm, nëpunësi ***** , brenda afatit 5 ditor nga data e marrjes dijeni, i është drejtuar njësisë përgjegjëse me shkresën e datës 01.06.2018, nëpërmjet të cilës ka kërkuar anulimin e aktit nr. 2397/44 prot., datë 25.05.2018, me arsyetimin se, transferimi i tij i dytë në pozicionin “*Specialist*” është kryer në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”.

Në lidhje me këtë fakt, nëpunësi ***** ka pretenduar se vendimi i Komisionit të Ristrukturimit përbën një akt të paligjshëm, pasi në kuptim të dispozitave të mësipërme

ligjore, Komisioni i Ristrukturimit ushtron kompetencat e tij deri në momentin e përmbylljes së procedurës së ristrukturimit nga njësia përgjegjëse dhe me kalimin e kësaj faze të procesit, ky organ nuk mund të marrë vendim për transferimin e nëpunësve civilë, nëse nuk ekziston ndonjë shkak i arsyeshëm, i bazuar në ligj.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, deri në momentin e shqyrtimit të ankesës nga Komisioneri, nuk rezulton që Departamenti i Administratës Publike, të ketë marrë në shqyrtim ankesën e këtij nëpunësi dhe të jetë shprehur në lidhje me pretendimet e ngritura prej tij.

Në lidhje me rastin konkret, në vlerësim të rrethanave të çështjes, si dhe dokumentacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, vlerëson se Komisioni i Ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse (DAP), kanë gabuar në zbatimin e ligjit material, në drejtim të procesit të vendimarrjes për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil, *****, si rrjedhojë e ristrukturimit të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Vlerësohet se kjo paligjshmëri ka ardhur si rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit jo të drejtë të legjislacionit të posacëm për shërbimin civil. Nëse do të ndodheshim në kushtet e nevojave institucionale, do të duhej të aplikoheshin përcaktimet e nenit 48 “*Transferim i përkohshëm*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Por, në rastet e ndryshimit të kërkesave të përgjithshme dhe të posaçme të pozicionit të punës, parashikohet një procedurë krejtësisht e ndryshme, e përcaktuar në nenin 50, të ligjit të sipërcituar.

Konkretisht, ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar në nenin 50, përcakton se në çdo rast mbylljeje apo ristrukturimi, krijohet një komision ristrukturimi. Ky komision, në bazë të dokumentacionit përkatës, shqyrton mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit civil në një pozicion të lirë të së njëjtës kategori, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike.

Vendimarrja e këtij komisioni bazohet në analizën e përshkrimeve të punës së pozicioneve të ristrukturuara, në ndryshimet e kriterëve specifike, si dhe në dosjen personale të nëpunësve në pritje të transferimit, duke evidentuar elementët kyç mbi të cilët do të bazohet vendimarrja, të tilla si përvoja, arsimi dhe vlerësimi i arritjeve.

Më tej, në përmbajtje të kësaj dispozite, si dhe të Kreut II, pika 20, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm*”, përcaktohet se, vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së propozimit nga Komisioni i Ristrukturimit.

Në lidhje me këtë moment procedural, me qëllim garantimin e një procesi të drejtë ligjor, në pikën 18, të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo restrukturimit të institucionit”, është parashikuar e drejta diskrete e Departamentit të Administratës Publike, për të kthyer aktet e Komisionit të Ristrukturimit, në rastet e konstatimit të parregullsive të dukshme ligjore, të cilat mund të kenë ndikuar direkt në përmbajtjen dhe drejtësinë e procesit të vendimarrjes për transferimin e nëpunësve civilë. Vetëm në të tilla raste, Komisioni i Ristrukturimit mund të vihet në lëvizje dhe rishikon aktet administrative të propozimit për transferimin e nëpunësve civilë dhe në përfundim, i dërgon propozimet e reja, Departamentit të Administratës Publike për miratim.

Miratimi i këtyre propozimeve dhe nxjerrja e vendimit përfundimtar të transferimit të përhershëm nga Departamenti i Administratës Publike, shënon dhe momentin e përfundimit të veprimtarisë së Komisionit të Ristrukturimit.

Në rastin konkret, në praktikën shkresore të procesit të restrukturimit të Autoritetit të Aviacionit Civil, nuk rezulton të ketë ndonjë akt apo praktikë administrative që të provojnë se, Departamenti i Administratës Publike ka konstatuar parregullsi apo elementë paligjshmërie në veprimin administrativ të transferimit të përhershëm të nëpunësit ***** , në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Çertifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit të Sigurisë, në Drejtorinë e Sigurisë në Aviacion e për këtë shkak të ketë bërë ndonjë ndërhyrje ligjore. Ekziston vetëm akti nr. 2397/36 prot., datë 10.04.2018, i Departamentit të Administratës Publike nëpërmjet të cilit, është miratuar transferimi i përhershëm i këtij nëpunësi, në pozicionin e sipërcituar.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar, procesi i rishikimit të procesit të transferimit të nëpunësit ***** , është vënë në lëvizje, në bazë të kërkesës nr. 902 prot., datë 08.05.2018, të Drejtorit Ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil, “Kërkesë për lëvizje paralele”, nëpërmjet të cilës është kërkuar shkëmbimi i pozicioneve të punës midis punonjësve ***** dhe ***** , me motivacionin: “Për shkak të nevojave institucionale të AAC”.

Referuar përcaktimeve të dispozitave të mësipërme, vlerësohet se titullari i institucionit nuk ka kompetencë ligjore të kërkojë prej Komisionit të Ristrukturimit, rishikimin e propozimit për transferimin e përhershëm të nëpunësve civile, me qëllim ndryshimin e pozicionit të punës. Pas përfundimit të procedurës së restrukturimit, çdo ndryshim i pozicionit të punës, duhet të realizohet nëpërmjet procedurave të konkurrimit, të lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, në përputhje me kërkesat e nenit 25 dhe 26, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt të ligjit.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, vlerëson se, Departamenti i Administratës Publike, i cili përbën mekanizmin kryesor për garantimin e zbatueshmërisë së legjislacionit të shërbimit civil në rastin konkret, nuk duhet të kishte lejuar kryerjen e veprimit të mësipërm administrativ dhe nuk duhet të nxirrte vendimin nr. 2397/44 prot., datë 25.05.2018, me të cilin është miratuar transferimi i rishikuar i nëpunësit ***** në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e të Drejtave të Pasagjerit, në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Operatorëve Ajrore dhe Organizatave të Mirëmbajtjes, në Autoritetin e Aviacionit Civil.

Nga sa është parashtruar më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, propozimi i dytë me nr. 958 prot., datë 17.05.2018, i Komisionit të Ristrukturimit, si dhe akti nr. 2397/44 prot., datë 25.05.2018, i Departamentit të Administratës Publike, “*Transferim për shkak të ristrukturimit*”, ndaj nëpunësit ***** , në kuptim të nenit 109, pika “b” dhe “d”, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, përbëjnë akte administrative të paligjshme dhe për këtë arsye, në referencë të po këtij ligji, këto akte duhet të shfuqizohen.

Në vijim të këtij arsyetimi, Komisioni i Ristrukturimit, duhet të shfuqizojë pjesërisht aktin nr. 958 prot., datë 17.05.2018, konkretisht pikën 3 dhe 4, të dispozitivit të këtij akti. Më tej, Departamenti i Administratës Publike, duhet të ndërmarrë veprimet për shfuqizimin e aktit nr. 2397/44 prot., datë 25.05.2018, “*Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit*”, ndaj nëpunësit ***** . Me qëllim rregullimin e paligjshmërisë, njësia përgjegjëse, duhet të shfuqizojë aktin administrativ me të cilin është disponuar transferimi i përhershëm i nëpunëses ***** , në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Çertifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit të Sigurisë, në Drejtorinë e Sigurisë në Aviacion, si një akt i dalë në zbatim të gabuar të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Me shfuqizimin e këtyre akteve administrative, njësia përgjegjëse DAP dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të Autoritetit të Aviacionit Civil duhet të marrin masa për rikthimin e nëpunësit ***** , në pozicionin “*Inspektor*”, në Sektorin e Çertifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit të Sigurisë, në Drejtorinë e Sigurisë në Aviacion, në të cilin është transferuar me aktin nr. 2397/36, datë 10.04.2018, të Departamentit të Administratës Publike.

Nga këqyrja e dokumentacionit të administruar gjatë hetimit paraprak, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, konstaton se, në aktet e njësisë përgjegjëse (DAP), në lidhje me transferimin e përhershëm në kuadër të ristrukturimit të Autoritetit të Aviacionit Civil, nëpunësi ***** pa të drejtë është trajtuar si “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, fakt që vjen në kundërshtim me përcaktimet e nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Rezulton se, në zbatim të nenit 67, të ligjit të sipërcituar, me aktin nr. 1606/20 prot., datë 30.10.2014, të Departamentit të Administratës Publike, për punonjësin në fjalë është deklaruar statusi i punësimit si *“Nëpunës civil në periudhë prove”*, për faktin se në momentin e hyrjes në fuqi të ligji për shërbimin civil, ky nëpunës ka qenë i punësuar për një periudhë me pak se një vit, në pozicionin *“Inspektor”*, në Sektorin e të Drejtave të Pasagjerit, në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Operatorëve Ajrorë dhe Organizatave të Mirëmbajtjes, në Autoritetin e Aviacionit Civil.

Nga tërësia e akteve të vëna në dispozicion, rezulton se në vijim, ky nëpunës ka kryer ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s, si dhe detyrimet e tjera ligjore, por eprori direkt, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk ka përmbyllur procesin e periudhës së provës, sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka konstatuar dhe trajtuar këtë parregullsi të administrimit të shërbimit civil, në vendimin nr. 38, datë 27.04.2018, me të cilën është miratuar raporti përfundimtar i mbikëqyrjes së kryer në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil. Në pikën 7, të këtij vendimi është urdhëruar që institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse për grupin e punonjësve, për të cilët është deklaruar statusi i punësimit si *“Nëpunës civil në periudhë prove”* (ku përfshihet edhe nëpunësi *****), të përmbillet duke finalizuar procesin e konfirmimit si nëpunës civil, sipas udhëzimeve të përcaktuara në përmbajtje të këtij dokumentacioni.

Konstatohet se, për mënjanimin e kësaj gjendje paligjshmërie, janë bërë përpjekje formale nga ana e administratorëve të shërbimit civil, gjë e cila materializohet me nxjerrjen e aktit nr.1089/1 prot., datë 11.06.2018 (pra, disa kohë pas kryerjes së ristrukturimit të dytë...), të eprorit direkt, me anë të të cilit nëpunësi ***** është konfirmuar si *“Nëpunës civil”*, në përfundim të periudhës së provës.

Në zbatim të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Kreut VI, pika 13, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, njësia përgjegjëse (DAP) ka finalizuar këtë proces me aktin nr. 4353/2 prot., datë 21.06.2018, nëpërmjet të cilës ka deklaruar statusin e punësimit në pozicionin e sipërpërmendur, për ankuesin.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se veprimet e mësipërme administrative, për mënjanimin e gjendjes së paligjshmërisë, vlerësohen si formale, për shkak se, në thelb ato nuk ishin në koherencë me zgjidhjen e drejtë dhe përfundimtare të problemit.

Rezulton se, nëpunësi *****, pas ndërhyrjes së Komisionerit, është konfirmuar “Nëpunës civil”, në pozicionin “Specialist”, në Sektorin e të Drejtave të Pasagjerit, në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Operatorëve Ajrore dhe Organizatave të Mirëmbajtjes, në Autoritetin e Aviacionit Civil, pra në një pozicion për të cilin në përmbajtje të këtij vendimi është argumentuar paligjshmëria e transferimit dhe është kërkuar shfuqizimi i akteve, duke kërkuar kthimin e këtij nëpunësi në pozicionin e punës, në të cilin është transferuar në momentin e kryerjes së ristrukturimit fillestar.

Në kuptim të dispozitave të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me shfuqizimin e këtyre akteve administrative, eprori direkt i nëpunësit *****, duhet të saktësojë vendimin nr. 1089/1 prot., datë 11.06.2018, në pjesën ku përcaktohet pozicioni i punës që mban dhe për të cilin konfirmohet nëpunësi në fjalë: “Inspektor, në Sektorin e Çertifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit të Sigurisë”, në Drejtorinë e Sigurisë në Aviacion.

Në të njëjtën kohë, në bazë të Kreut VI, pika 13, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” dhe nenit 114, pika 1, të “Kodit të Procedurave Administrative”, të veprjës edhe Departamenti i Administratës Publike, i cili duhet të saktësojë aktin nr. 4353/2 prot., datë 21.06.2018, duke deklaruar statusin e punësimit për nëpunësin *****, në pozicionin e sipërcituar, “Inspektor, në Sektorin e Çertifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit të Sigurisë”, në Drejtorinë e Sigurisë në Aviacion.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkojë nga Komisioni i Ristrukturimit për Autoritetin e Aviacionit Civil, ngritur me urdhrin nr. 12, datë 07.02.2018, të Departamentit të Administratës Publike, të shfuqizojë pjesërisht aktin nr. 958, datë 17.05.2018, konkretisht pikën 3 dhe 4, të dispozitivit të këtij akti, në të cilin propozohet shkëmbimi i pozicioneve të punës midis punonjësve ***** dhe *****, si një akt i dalë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

2. Departamenti i Administratës Publike, duhet të shfuqizojë aktin nr. 2397/44 prot., datë 25.05.2018, “*Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit*”, ndaj nëpunësit *****, në pozicionin “*Inspektor, në Sektorin e Certifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit të Sigurisë*”, si dhe aktin nr. 3937/2 prot., datë 25.05.2018, “*Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit*”, ndaj nëpunëses *****, në pozicionin “*Inspektor, në Sektorin e Çertifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit të Sigurisë*”, në Drejtorinë e Sigurisë në Aviacion.
3. Njësia përgjegjëse (DAP) dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil, duhet të marrin masa për rikthimin e punonjësit *****, në pozicionin “*Inspektor, në Sektorin e Certifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit të Sigurisë*”, në Drejtorinë e Sigurisë në Aviacion, sipas aktit nr. 2397/36 prot., datë 10.04.2018, të Departamentit të Administratës Publike, “*Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit*”.
4. Eprori direkt i nëpunësit (*Drejtori i Drejtorisë së Sigurisë në Aviacion*), në zbatim të nenit 114, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, duhet të shfuqizojë vendimin nr. 1089/1 prot., datë 11.06.2018, në pjesën ku emërtohet pozicioni për të cilin bëhet konfirmimi, duke saktësuar se nëpunësi *****, konfirmohet në pozicionin “*Inspektor, në Sektorin e Certifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit të Sigurisë*”, në Drejtorinë e Sigurisë në Aviacion.
5. Më tej, njësia përgjegjëse, në zbatim të detyrimit të përcaktuar në kreun VI, pika 13, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*” dhe nenit 114, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, duhet të shfuqizojë pjesërisht aktin nr. 4353/2 prot., datë 21.06.2018, duke deklaruar statusin e punësimit për nëpunësin *****, në pozicionin “*Inspektor, në Sektorin e Certifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit të Sigurisë*”, në Drejtorinë e Sigurisë në Aviacion.
6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë, nga marrja dijani për këtë vendim.
7. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
8. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të

konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

9. Të njoftohet për këtë vendim, Autoriteti i Aviacionit Civil, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi *****.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

Konceptoi: Matilda Idrizaj, inspektor i KMSHC

Pranoi: Ilia Kukumi, Drejtor i I&H. Administrativ

Miratoi: Arbana Basha, Drejtor i Përgjithshëm i Mbikëqyrjes dhe Inspektimit